

Fjalimi i Guvernatorit në Konferencën “**Iniciativa për implementimin e shtyllës së dytë të kornizës rregullative të Basel-it: ICAAP/SREP dhe shembuj praktikë**”

Shkëlqesia juaj, ambasadorja Viets,

I nderuari z. Macbeth,

I nderuar z. Christiansen,

Të nderuar të pranishëm,

Zonja dhe zotërinj,

Kam kënaqësi të veçantë t’ju uroj mirëseardhje në *Konferencën mbi implementimin e shtyllës së dytë të kornizës rregullative të Bazelit*, të cilën e kemi organizuar në bashkëpunim me GIZ-in.

Në emër të Ministrisë Federale të Republikës së Gjermanisë për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, GIZ-i është pa dyshim njëri ndër përkrahësit më të mëdhenj të forcimit të kapaciteteve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Me këtë rast, dua të shpreh falënderim të veçantë si për personelin, po ashtu edhe për partnerët e angazhuar të GIZ-it.

Jemi të nderuar me pjesëmarrjen e ekspertëve të mbikëqyrjes bankare që vijnë nga Banka Qendrore Evropiane dhe nga institucione të ndryshme kompetente të vendeve të Bashkimit Evropian. Po ashtu, dua të shpreh mirënjohjen për përfaqësuesit e bankave qendrore të vendeve të rajonit, të cilët po marrin pjesë në këtë konferencë.

Edhe ky projekt është në vazhden e mbështetjes së vazhdueshme institucionale që BQK-ja ka marrë nga donatorët ndërkombëtarë, siç janë SHBA-të dhe vendet e BE-së, në rastin konkret Gjermania.

Organizimi i kësaj konference ka për synim të ofrojë një tryezë diskutimesh, e cila do të ndihmojë në afrimin drejt standardeve ndërkombëtare të rregullimit të

sektorit bankar sa i përket adekuatshmërisë së kapitalit në proporcion me profilin e rrezikut, duke u përqendruar në vlerësimin nga vetë bankat dhe në rishikimin nga autoriteti mbikëqyrës.

Në kushtet dhe në rrethanat bashkëkohore ekonomike dhe financiare në botë, adoptimi i këtyre standardeve po bëhet i pashmangshëm për çdo vend. Për vendet e rajonit tonë, nëpërmjet arritjes së këtyre standardeve, jo vetëm që mbështetet zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit bankar, por edhe plotësohet një pako shumë e rëndësishme e kriterëve të kërkuara në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian.

Banka Qendrore e Kosovës që nga themelimi i saj, në fushën e mbikëqyrjes bankare, ka qenë e orientuar kah standardet dhe praktiket më të mira ndërkombëtare. Fillimi i funksionimit të BQK-së korrespondoi me një periudhë kur vendet e tjera ish-socialiste të Evropës kishin arritur të normalizonin gjendjen në sektorët e tyre bankarë, pas një procesi të konsiderueshëm tranzicioni, gjatë të cilit lëshimet e bëra në fillim të këtij procesi, kishin bërë që tranzicioni të ishte i gjatë dhe i vështirë. Kriteret e lehta të licencimit për institucionet financiare vendore, vonesat për të lejuar hyrjen e bankave të huaja, si dhe mungesa e kapaciteteve adekuate institucionale, duke përfshirë edhe mangësitë e kapaciteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse të bankave qendrore, ishin disa nga shkaqet kryesore të problemeve me të cilat u ballafaquan sektorët bankarë të këtyre vendeve.

Mësimet e nxjerra nga përvojat që kishin bankat qendrore të vendeve të rajonit si dhe praktiket më të mira ndërkombëtare shërbyen si një bazë e fortë për zhvillimin e BQK-së dhe për ndërtimin e një sistemi financiar, duke mos trashëguar asgjë nga sistemi i kaluar.

Prandaj, me ndihmën e madhe të partnerëve ndërkombëtarë, BQK-ja u përcaktua të zhvillojë aktivitetin e saj duke ndjekur standardet bashkëkohore

ndërkombëtare, nëpërmjet të cilave arritëm të ndërtojmë një sistem financiar modern dhe të bazuar në parimet e ekonomisë së tregut të lirë.

Në këtë mënyrë, BQK-ja vendosi bazat e një sistemi financiar të bazuar në pronësi private dhe që nga fillimi hapi dyert për hyrjen e institucioneve të huaja financiare. Në të vërtetë, ishin institucionet e huaja financiare, veçanërisht bankat, të parat që filluan aktivitetin në Kosovë, duke sjellë përvojat bashkëkohore të industrisë financiare.

Aktualisht, sistemi financiar i Kosovës karakterizohet me një pjesëmarrje të lartë të kapitalit të huaj, ku në veçanti dëshiroj të theksoj sektorin bankar, në të cilin rreth 90 përqind e aseteve të sektorit menaxhohet nga bankat në pronësi të huaj.

BQK-ja në vazhdimësi ka ndjekur një politikë të shëndoshë të licencimit të institucioneve financiare, ka bërë avancim të vazhdueshëm të kornizës rregullatore në harmoni me standardet ndërkombëtare, si dhe është angazhuar për zhvillim të vazhdueshëm të kapaciteteve mbikëqyrëse, duke ndërtuar kështu themele të shëndosha për zhvillimin e sistemit financiar të Kosovës. Këto të arritura dolën në pah sidomos gjatë krizës së fundit financiare globale, kur sistemi financiar i Kosovës, dhe në veçanti sektori bankar, arriti të ruajë qëndrueshmërinë dhe vazhdoi të mbështesë stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik të vendit.

Aktualisht, sektori bankar i Kosovës paraqet një kontribuues shumë të rëndësishëm në financimin e ekonomisë së vendit dhe gëzon shëndet financiar shumë të mirë bazuar në të gjithë treguesit relevantë. Cilësia e portofolit kreditor, që edhe më parë ishte në nivel mjaft të mirë, gjatë vitit 2015 shënoi përmirësim të mëtejshëm. Në fund të vitit, norma e kredive jopërfomuese u zvogëluar në 6.2 përqind, në krahasim me 8.3 përqind sa ishte një vit më parë. Sektori bankar po ashtu vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit, me

tregues të mjaftueshmërisë së kapitalit prej rreth 19 përqind, që është dukshëm më i lartë se sa minimumi i kërkuar rregullator. Gjendja e likuiditetit vazhdon të jetë e kënaqshme, me treguesin e likuiditetit që qëndron në rreth 43 përqind, që është dukshëm më i lartë se sa minimumi i kërkuar rregullator prej 25 përqind.

Megjithatë, përkundër këtyre të arriturave, jemi të vetëdijshëm se dinamika me të cilën po zhvillohet industria financiare në rrafshin global paraqet sfida të vazhdueshme për rregullatorët financiarë. Prandaj, jemi të përkushtuar t'i ndjekim për së afërmi zhvillimet në industrinë financiare dhe po ashtu zhvillimet në fushën e standardeve të rregullimit financiar. Në këtë drejtim, në planin aktual strategjik të BQK-së, i cili përmban prioritetet zhvillimore afatmesme, vëmendje e posaçme i është kushtuar edhe avancimit të kornizës rregullatore në linjë me standardet ndërkombëtare dhe aktet juridike të BE-së. Po ashtu, vlen të theksohet se vitin e kaluar, kemi pranuar një kontribut shumë të rëndësishëm nga Banka Qendrore Evropiane, e cila nëpërmjet një programi të bashkëpunimit për lehtësimin e integritimit evropian ka bërë identifikimin e nevojave zhvillimore të BQK-së në fusha të ndryshme të veprimtarisë, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen bankare dhe stabilitetin financiar.

Si rrjedhojë, është ndërtuar një shteg i qartë që duhet ndjekur për zhvillimin e mëtejshëm të detyrave mbikëqyrëse të BQK-së. Ecja nëpër këtë shteg padyshim se do të ballafaqohet me sfida të ndryshme, mirëpo unë kam besimin e plotë se të arriturat e deritanishme, përkushtimi dhe profesionalizmi i lartë i personelit tonë, së bashku me përkrahjen e vazhdueshme të institucioneve vendore e ndërkombëtare, garantojnë arritjen e suksesshme në cak.

Si pjesë të kësaj ecjeje e shoh edhe mbajtjen e kësaj konference, dhe dua të theksoj mirënjohjen time për të gjithë pjesëmarrësit e konferencës, të cilët me prezantimet dhe diskutimet e tyre do të kontribuojnë në mbarëvajtjen e saj.

Shpresoj që ngjarje të këtilla, me një pjesëmarrje kaq të gjerë të ekspertëve, do të kemi rastin të shohim sa më shpesh në Kosovë dhe në rajon.

Ju faleminderit!